



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:069541
Datë: 29.09.2023
Numri i dokumentit: 04733580

CP.nr.122/22

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Durim BALAJ, me bashkëpunëtorin profesional Zef Qupi, në çështjen juridike të përmbarrimit sipas propozimit për përmbarrim të kreditores N.K., nga Komuna e Gjakovës, të cilën e përfaqëson Arbër Guta avokat në Prishtinë, kundër debitorës së përmbarrimit Komunës së Gjakovës - DKA, për përmbarrimin e dokumentit të ekzekutueshëm – aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë, C.nr.428/21 të datës 10.01.2022, për shkak të detyrimit në të holla në emër të kompensimit për shpenzime të ushqimit dhe udhëtimit në punë si dhe shpërblimit jubilar, në shumën e përgjithshme prej 3,165.08 euro, duke vendosur për debitimin e mjeteve përmes xhirollogarisë bankare, jashtë seancës gjyqësore, më 28 shtator 2023, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.URDHËROHET Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Republikës së Kosovës në Prishtinë – Llogaria e vetme e Thesarit, që në emër të detyrimit të përcaktuar me aktvendimin e kësaj gjykate, CP.nr.122/22 të datës 14.03.2022, për lejimin e përmbarrimit të dokumentit të ekzekutueshëm - Aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.428/21, të datës 10.01.2022, për shkak të detyrimit në të holla në emër të kompensimit shpenzime të ushqimit dhe udhëtimit në punë si dhe shpërblim jubilar, kreditores N.K., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumën prej 2,134.28 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumën prej 361.60 euro si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe përmbarrimore në shumën prej 669.20 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 3,165.08 euro, të gjitha në afat prej 7 ditësh, në atë mënyrë që nga xhirollogaria e debitorës së përmbarrimit, Komuna e Gjakovës -

DKA, të barten këto mjetet monetare, në llogarinë e të autorizuarit të kreditores av.Arbër Guta në xhirollogarinë e tij bankare, me Nr..... pranë Bankës NLB.

II. OBLIGOHET Kreditori dhe Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve – Llogaria e vetme e Thesarit në Prishtinë, që gjykatën ta njoftoj me shkrim për zbatimin e këtij aktvendimi ose për arsyet e mos zbatimit të tij.

A r s y e t i m

Gjykata aktvendimin CP.nr.122/22 të datës 14.03.2022, me të cilin e ka caktuar përmbartimin në këtë çështje përmbartimore, ia ka dërguar të paditurës, mirëpo e njëjta edhe pse e ka pranuar të njëjtin me datën 21.03.2022, brenda afatit ligjor nuk ka ushtruar prapësim.

Meqenëse pala kreditore në propozimin e saj për përmbartim, ka cekur mjetin e përmbartimit - transferimin e mjeteve monetare përmes xhirollogarive bankare e me qëllim të realizimit të detyrimit të lartë cekur në të holla dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, kjo gjykatë gjeti se në rastin konkret, duhet të bëhet debitimi i mjeteve të lartcekura monetare, përkatësisht t'ia paguaj kreditores N.K., nga Gjakova, t'ia paguaj në emër të borxhit kryesor shumë prej 2,134.28 euro, në emër të kamatës ligjore prej 8% të borxhit kryesor shumë prej 361.60 euro si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore dhe përmbartimore në shumë prej 669.20 euro, përkatësisht shumë e përgjithshme prej 3,165.08 euro, dhe atë për këto arsye:

Nga shikimi i shkresave të lëndës, CP.nr.122/22, kjo gjykatë ka gjetur se në rastin konkret pjesë e detyrimit që rrjedh nga dokumenti i përmbartimit – aktgjykimit të Gjykatës Themelore Gjakovë, C.nr.428/21, të datës 10.01.2022, i plotfuqishëm me datë 15.02.2022, dhe i ekzekutueshëm me datë 25.02.2022, për shkak të detyrimit në të holla, duke u bazuar në dokumentin e lartcekur të përmbartimit si dhe nenin 152 të LPP-së, debitorja, është e obliguar që kreditores së përmbartimit, t'ia paguaj shumën e lartcekura të gjitha në afat prej 7 ditësh, andaj në arsyet e cekura më lart kjo gjykatë, vendosi që ta urdhëroj Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve në Prishtinë - Llogarinë e Thesarit, që të bëjë debitimin e mjeteve monetare si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nga të lartcekurat, gjykata duke u bazuar në nenet 3, 5 par.6 pika 2, 109 par.3, 113 dhe nenin 152 të LPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Numri i lëndës: 2021:069541
Datë: 29.09.2023
Numri i dokumentit: 04733580

- Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil -
CP.nr.122/22, më 28 shtator 2023

GJYQTARI,
Durim BALAJ

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesë e veçantë.